



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës  
Autoritet Kosova za Konkurenciju  
Kosovo Competition Authority



*Konkurrenca është e mirë,  
e rregulluar është më e mirë*

AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS  
AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU  
KOSOVO COMPETITION AUTHORITY

# RAPORTI VJETOR 2020



TË DHËNAT E PUBLIKUARA

Publikuar nga:

**AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS**

Adresa:

Ndërtesa e ish “Bankës së Lubjanës”, kati VI

Rruga “Migjeni”, pn. Prishtinë

Tel: 038 200 109 82

Web: <http://ak.rks-gov.net>

Mars 2021

# Përmbajtja

FJALA HYRËSE .....	3
PËRMBLEDHJE .....	4
KORNIZA LIGJORE .....	6
PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT .....	7
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT .....	7
FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI .....	8
RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUdhËN RAPORTUESE .....	9
1. Marrëveshjet e ndaluara .....	9
2. Pozita Dominuese .....	21
3. Përqendrimet .....	24
4. Mendimet Profesionale .....	29
5. Tregjet e monitoruara .....	36
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR .....	39
PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA TË PARAQITURA NË FORMË TABELARE .....	40
SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT .....	41
RAPORTI FINANCIAR .....	42
RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-it .....	43

## FJALA HYRËSE

---

### Valon PRESTRESHI

#### Kryetar, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Që nga fillimi i vitit 2020 pandemia me COVID-19 ka formësuar jo vetëm jetën e përditshme të njerëzve, por edhe kushtet e kornizës ekonomike. Ligji i konkurrencës ka dëshmuar të jetë një mjet fleksibël në këtë situatë të jashtëzakonshme. Në shumë sektorë ndermarrjet duheshin të bashkëpunonin me njëra-tjetrën për të reaguar ndaj ngushticave në prodhimin, magazinimin, logjistikën dhe shpërndarjen e mallrave.

Rinisja e aktivitetit të biznesit mund të kërkojë që konkurrentët të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin ose të koordinojnë nga afër aktivitetin e biznesit me furnitorët e tyre që në rrethana normale do të ishte problematike sipas Ligjit të Konkurrencës. Në koordinim të ngushtë me Autoritetet e Konkurrencës të rajonit, logjikën e ndjekur nga Komisionin Evropian dhe autoritetet tjera brenda Evropës, ne kemi bërë të qartë që levizjet degresive të ekonomisë do të merren parasysh në vlerësimin e sjelljeve anti-konkurrese. Në mënyrë të shpejtë dhe jo-burokratike ne kemi luajtur një rrol proaktive, avokues dhe shumë bashkëpunues me ndërmarrje të ndryshme për t'ia lehtësuar atyre veprimtarinë ekonomike.

Bashkëpunimi me ndërmarrjet e ndryshme ishte në nivel të knaqshem, dhe preventimi i karteleve apo abuzimeve me pozitën dominuese në tregje të caktuara ishte në nivel, marrë për bazë kushtet e jashtëzakonshme që po kalonte ekonomia e Kosovës, bizneset e sajë dhe qytetarët në përgjithsi.

Avokimi me akterë të ndryshëm të shoqërisë doli të ishte instrumenti më i sukseshëm gjatë pandemisë. Ne arritëm që në masë të konsiderueshme të përçojmë informatën e duhur dhe të saktë tek qytetarët tanë, dhe ta eliminojmë panikun e ngritur, sidomos në aspektin e mungesës së produkteve bazë ushqimore dhe ne arritëm të parandalojmë ngritjen e çmimeve të tepruara apo (Price gouging), në shumë produkte. Në kuader të instrumentit të Avokimit, bashkëpunimi me medie dhe shoqëri të civilë, ishte i shquar, ata luajtën një rrol ekselent të informimit për qytetarët dhe për mekanizmin shtetërorë.

Po ashtu kemi qenë pjesë e komitetit ndërshtetëror për menaxhimin e pandemisë gjatë vitit 2020. Ky komitet është udhehequr nga Kryeministri Kurti, dhe janë mbajtur disa takime koordinuese dhe raportuese për situatën në terren.

Nga aspekti i rasteve, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë vitit 2020 ka trajtuar raste të ndjeshme, dhe të interesit të gjithëmbarshtëm shoqërorë. Ka marrë vendim përfundimtar duke shqiptuar sanksione administrative ndaj 14 ndërmarrjeve të derivateve të naftës në shumë me mbi 4 Milion Euro.

Gjithashtu, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) ka filluar procedurë hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS dhe KESCO, të cilat operojnë në tregun e energjisë elektrike. Hetimi ndaj këtyre ndërmarrjeve është autorizuar nga Komisioni i AKK-së dhe vjen si rezultat i një studimi të detajuar të tregut të energjisë në Kosovë.

Vendimet tjera janë të elaboruara në mënyrë të detajuar në këtë raport.

## PËRMBLEDHJE

---

Në përputhje me detyrimin ligjor, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) raporton çdo vit në Kuvendin e Kosovës. Raporti Vjetor për vitin 2020 i përshkruan aktivitetet e AKK-së dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AKK-së, duke i siguruar lidhur me transparencën e punës së tij dhe ndërgjegjësimin e ngritur për kulturën e konkurrencës në Republikën e Kosovës.

Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AKK-së janë përcaktuar në Statutin e tij, i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës. Komisioni i AKK-së është organ kolegjal që menaxhon me punën e Autoritetit, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, njeri prej të cilëve është kryetar i Komisionit.

Kryetari i Komisionit udhëheq organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e Autoritetit dhe është përgjegjës për punën profesionale të Autoritetit.

Komisioni miraton vendimet e tij në mbledhjet e tij, me shumicën e votave, ku asnjë anëtar i Komisionit nuk mund të abstenojë nga votimi. Vendimet mund të merren vetëm nëse në seancë janë të pranishëm kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit dhe së paku dy anëtarë të tjerë të tij.

Fushëveprimi i AKK-së konform Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës trajton tri (3) shtyllat kryesore të keqperdorimit apo shtremberimit të konkurrencës: 1. Marreveshjet e ndaluara - Kartelet, 2. Abuzimi me Poziten Dominuese, 3. Përqendrimet apo bashkimet e palejuara.

Gjate pandemise, AKK ka zhvilluar aktivitete proaktive, duke avokuar, parandaluar dhe sensibilizuar opinionin e gjithëmbarsheëm rreth panikës së krijuar nga qytetarët në aspektin e furnizimit me artikuj bazik ushqimor (siç është mielli, kripa, vaji), dhe artikuj higjienik. Kemi arritur që ne mase të konsiderueshme të ndikojmë pozitivisht në uljen e panikut të qytetarëve, të ngrisim vetedijen e tregtarëve dhe prodhuesve, e që bashkepunimi ndërmjet sektorit privat me Autoritetin e Konkurrencës ka qenë në nivel.

Si rezultat i aktiviteteve në terren dhe kampanjave sensibilizuese, AKK ka pranuar 130 ankesa të ndryshme nga qytetarët e Kosovës. E që me kujdes dhe profesionalizem i'u kemi dhënë përgjigje meritore secilës ankesë.

Pas vendimit të Bordit për Licencim të Institucioneve Private Shëndetësore për lejimin e shërbimeve të testimeve për SARS-Cov 2, me Ministrinë e Shëndetësisë kemi dakorduar që të koordinohemi ngushtë që ky proces të zhvillohet duke respektuar politikat e konkurrencës. Autoriteti ka marrë zotime, që të monitorojë sjelljen e këtyre institucioneve lidhur me caktimin e çmimeve të këtij shërbimi, si dhe t'iu bëjmë me dije institucioneve të licencuara se ky proces do të monitorohet nga autoritetet shtetërore.

AKK ka marr vendimin më të madh për shqiptimin e masës së sanksionit administrativ në vlerë me mbi 4(katër) milion euro ndaj 14 ndërmarrjeve të derivateve të naftës. Me kete vendim kemi arritur që t'i edukojmë dhe sensibilizojmë ndërmarrjet që operojnë në këtë treg, se fiksimi i çmimeve është i dëmshëm për shoqërinë dhe vetë ndërmarrjet në një sistem ekonomike të tregut të lirë.

Përveç aktiviteteve të AKK-së për zbatimin e rregullave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, AKK gjithashtu ka qenë në mënyrë aktive e përfshirë edhe në promovimin e kultures së konkurrencës në vend.

Në kuadër të aktiviteteve primare në fushën e konkurrencës në vitin 2020, AKK ka trajtuar katërbëdhjet raste (14) raste, ka monitoruar industrinë e sigurimeve, tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë gjatë periudhës së pandemesë, sektorin e telekomunikacionit, tregun farmaceutik, laboratorët për tesimin SARC-COV19 dhe tregun e shërbimeve të radio taksive.

Periudha e raportimit dhe sidomos pjesa e parë e vitit 2020 shënoi një aktivitet në rritje të AKK-së në fushën e kompletimit të legjislacionit sekondar, i cili është një rezultat i drejtpërdrejtë i konsolidimit të Autoritetit dhe forcimit të rolit të tij rregullativ.

Promovimi i politikave të konkurrencës si shtyllë e rëndësishme e Ligjit, është një domosdoshmëri e punës së përditshme të AKK-se. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2020, AKK ka arritur të nënshkruaj Memorandum të Mirëkuptimit me Zyren Rregullatore të Energjisë dhe me Policinë e Kosovës.

Të gjeturat kryesore të monitorimit të tregut nga ana e AKK-së publikohen rregullisht në përputhje me politikën e saj të transparencës dhe me qëllim të promovimit të efekteve të vendimeve, opinionëve dhe veprimtarive të tjera brenda komunitetit të biznesit, konsumatorëve, autoriteteve të administratës publike, akademikëve, ekspertëve dhe publikut të gjerë.

Mbështetja e projektit e financuar nga Komisionit Evropian për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës është një komponent e rëndësishme në avancimin profesional të institucionit. Projekti ka luajtur një rol të veçantë në këtë drejtim, duke i ofruar stafit të AKK-së trajnimë themelore dhe të avancuara në fushën dhe politikën e konkurrencës. Projekti njëherazi ka ofruar mendime dhe opinionë, menaxhmentit rreth hartimit të metodologjive studiuuese të tregjeve, metodave investigative dhe grumbullimin e fakteve.

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka qenë përfitues i projektit IPA2017 nga KE, me një vlerë me mbi 4 Milion Euro në një periudhë 3 vjeqare.

## KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i ngarkuar për zbatimin e këtyre akteve ligjore dhe nën ligjore, e të cilat janë:

Ligjet	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ligji Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;</li> <li>2. Ligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;</li> <li>3. Ligji nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative</li> </ol>
Statuti	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Statuti i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312</li> </ol>
Udhëzimet Administrative	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2012 për formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit;</li> <li>2. Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël;</li> <li>3. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes së kërkesës dhe kriteret për konstatimin e përqendrimit të ndërmarrjeve;</li> <li>4. Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 mbi kriteret për lirimin ose uljen e masës administrative;</li> <li>5. Udhëzim Administrativ Nr. 02-2017 për përjashtimin grupor të <b>marrëveshjeve horizontale</b>;</li> <li>6. Udhëzim Administrativ Nr.03-2017 mbi përjashtimet grupore të <b>marrëveshjeve vertikale të ndërmarrësve</b>;</li> <li>7. Udhëzim Administrativ Nr. 04-2017 për përjashtimet grupore të <b>marrëveshjeve në sektorin e transportit</b>;</li> <li>8. Udhëzim administrativ Nr. 05-2017 për përjashtimet grupore të <b>marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve</b></li> <li>9. Udhëzim Administrativ Nr. 06-2017 për përjashtimin grupor të <b>marrëveshjes për d.s.a.m.</b></li> <li>10. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative;</li> <li>11. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 mbi mënyrën dhe kriteret për konstatimin e tregut përkatës - relevant;</li> </ol>
Rregulloret	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Rregullore Nr. 04/2018 e punës së Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;</li> <li>2. Rregullore nr. 03/2018 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës</li> <li>3. Rregullore Nr.01-2017 për procedurën hetimore të AKK-së;</li> <li>4. Rregullore nr. 02/2019 për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit</li> <li>5. Rregullore nr. 01/2019 për disa kategori të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimi</li> </ol>
Memorandumet me Shtete	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. MOU me Republikën e Shqipërisë</li> <li>2. MOU me Republikën e Maqedonisë së Veriut</li> <li>3. MOU me Republikën e Kroacisë</li> <li>4. MOU me Republikën e Turqisë</li> <li>5. MOU me Republikën e Bullgarisë</li> <li>6. MOU me Republikën e Austrisë</li> </ol>
Memorandumet e brendshme	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. MOU me Policinë e Kosovës</li> <li>2. MOU me Zyren Rregullatore të Energjisës</li> </ol>

Në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Komisioni i AKK-se ka hartuar draft Ligjin e Ri për Mbrojtjen e Konkurrencës i cili pritet të aprovohet në kuvend gjatë vitit 2021.

## PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në zbatim të rregullave të MSA-së, sipas të cilit është parashikuar detyrimi dhe angazhimi që ka Shteti i Kosovës për përafrimin e legjislacionit me atë evropian, përgjatë vitit 2020 ka vijuar këtë proces, duke synuar që kuadri ligjor në fushën e konkurrencës, të shkojë gradualisht drejt përafrimit të plotë me legjislacionin evropian.

Autoriteti i Konkurrencës e konsideron shumë të rëndësishëm, jo vetëm procesin e përafrimit të këtij legjislacioni, por edhe shkallën e zbatueshmërisë së rregullave dhe dispozitave përkatëse.

Aktet e miratuara, në nivel sekondar nga Komisioni i Konkurrencës, synojnë zbatimin e politikave të konkurrencës, me qëllim që ato t'i vijnë në ndihmë dhe të lehtësojnë procedurat dhe kohëzgjatjen e tyre në sektorin e biznesit.

Autoriteti ka kompletuar draft Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës i dërguar për aprovim në Qeveri. Ky draft Ligj ka të inkorporuar brenda tij principet, rregullat dhe dispozitat bazike të BE-se për konkurrencë nga Traktati për Funkcionimin e BE-së. Gjithashtu pjesërisht ka transpozuar Rregulloren e Këshillit 1/2003/KE, Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 773/2004, dhe Rregulloren e Këshillit 139/2004/KE (të ashtuquajturat “Rregulloret bazë të konkurrencës”).

## PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 07 nëntor 2008, në bazë të Ligjit për Konkurrencën Nr. 2004/36.

Autoriteti është person juridik me autorizime publike i cili në mënyrë të mëvetësishme dhe të pavarur kryen punët duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Qëllimi i mbrojtjes së konkurrencës është para së gjithash krijimi i përfitimeve për konsumatorët dhe krijimi i kushteve të barabarta për të gjitha bizneset në treg, të cilat duke u sjellur në pajtim me rregullat ekzistuese dhe duke garuar në treg me cilësitë, çmimet dhe inovacionet e produkteve dhe shërbimeve të tyre, i kontribuojnë zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë.

Kur kemi të bëjmë me ndërmarrësit dhe sjelljet e tyre antikonkurrese, si për shembull lidhja e Marrëveshjeve me

konkurrentët për çmimet, abuzimi me pozitën dominuese ose kontrolli i përqendrimeve, pra bashkimi dhe zmadhimi i ndërmarësve, Autoriteti e bënë vlerësimin e sjelljeve të tilla i ndëshkon shkelësit e rregullave dhe ju dërgon mesazhe unike të gjithë pjesëmarrësëve në treg.





Pra iniciativat e lira të ndërmarrësve nuk guxojnë të kufizohen, por zhvillimi i tyre kryhet sipas rregullave rigorozë të konkurrencës në treg, të cilat nuk janë vetëm represive, por edhe parandaluese.

Një nga detyrat më të rëndësishme të Autoritetit është promovimi i kulturës së konkurrencës dhe hetimi i veprimeve të ndërmarrjeve të cilat shtremberojnë dhe kufizojnë konkurrencën e lire dhe efektive.

Qëllimi ynë është që t'i kontribuojmë mirëkuptimit të problemit të konkurrencës në treg në të gjitha strukturat e Autoriteteve ekzekutive, legjislative e gjyqësore dhe të marrim pjesë në ndryshimet e tyre, si dhe ta informojmë administratën shtetërore, por edhe shtresat e gjëra të qytetarëve, lidhur me fenomenet të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e konkurrencës.

Nga konkurrenca në fund të fundit përfitojnë të gjithë: konsumatorët, bizneset dhe ekonomia në tërësi. Ajo ofron një ofertë dhe cilësi më të mirë si dhe çmime më të ulëta të produkteve dhe shërbimeve, e inkurajon inovacionin dhe ndikon në rritjen ekonomike.

Andaj edhe rritja e ndërgjegjësimit për nevojën e promovimit të saj është detyrë e jona.

## FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

---

### STRUKTURA ORGANIZATIVE E AUTORITETIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni që është organ kolegjal vendimmarrës dhe Sekretariati që e përbëjnë nëpunësit civil si staf profesional dhe mbështetës.

### STRUKTURA ORGANIZATIVE E SEKRETARIATIT

Sekretariati i Autoritetit është organ administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e rasteve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati pas monitorimit dhe hetimeve harton raportet të cilat paraqiten pranë Komisionit për vendimmarrje.

*Sekretariati përbëhet nga dy Departamente:*

#### 1. Departamenti Juridik dhe Administratës

Zhvillon politikat kadrovike dhe planet e Autoritetit për menaxhimin e personelit, koordinon procesin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve, siguron përputhshmërinë e ligjeve dhe akteve nënligjore të propozuara nga Autoriteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*Acquis Communautaire*) si dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Ky Departament në bashkëpunim me Komisionin, Sekretarin dhe Drejtorët e Departamenteve përgatit planifikimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, siguron përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të KASH-it, SZHMB-së, planit të keshit, pasqyrave e raporteve financiare, barazimet me Thesarin, regjistrimin e të hyrave, si dhe siguron e mbikëqyr shërbimet teknike si mirëmbajtjen, servisimin dhe regjistrimin e rregullt të

automjeteve, regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së Autoritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ky Departament ka 6 të punësuar dhe ka nevojë edhe për 1 zyrtarë të lartë ligjor.

## 2. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut

Mision kryesor ka hetimin e shkeljeve të konkurrencës në treg, ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj.

Ky Departament synon që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara me ligj, të mbikëqyr tregun dhe të propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të saj në treg, mbikëqyrë hetimin e tregjeve ku shfaqen praktikant anti-konkurrese, si ato të abuzimit me pozitën dominuese në treg, marrëveshjet e ndaluara dhe nëpërmjet përqendrimeve që krijojnë apo forcojnë pozitën dominuese pas përqendrimit, ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga bizneset dhe nga institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të përfshira ose jo nën hetim, etj.

Ky Departament ka 4 divizione (i Marrëveshjeve të ndaluara, i Pozites Dominuese, i Përqendrimeve dhe divizioni i Analizës, metodologjise dhe të drejtave ekskluzive).

## RASTET E TRAJTUARA PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

1. MARRËVESHJET E NDALUARA		
Rasti 1	15.10.2020 - Konkluzion per Noteret kunder Ministrise se Drejtësisë <i>“Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatohet se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj Ministrisë së Drejtësisë në çështjen e procesit të përzgjedhjes së Noterëve”.</i>	<p>1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në ushtrimin e funksionit të tij zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përveç në rastet kur me Ligjin nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe plotësim ndryshimin e tij përcakton ndryshe. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe misioni i AKK-së është të nxitë siguroje qasje në treg të lirë për çdo ndërmarrje e cila i plotëson kushtet për të konkurruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojnë me çmim dhe cilësi.</p> <p>2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është në zbatim të Ligjit nr. 03/L-229 dhe angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës( Abuzimi me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikant e Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme ) nga ndërmarrjet private apo publike në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj nëse këto veprime kanë efekt në Kosovë andaj;</p>

		<p>3. Neni 119 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për mbrojtjen e tregut të lirë, kushtetuta përcakton parimet e përgjithshme lidhur me marrëdhëniet ekonomike. Në përputhje me këtë, Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut dhe lirinë e aktivitetit ekonomik, duke shtuar se “veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”.</p> <p>4. Prandaj, shihet se Kushtetuta ofron hapësirë ligjore, që në disa situata, përmes ligjeve të veçanta të sektorëve specifik, të ndërmerren veprime të cilat nuk cilësohen si ndërhyrje në aktivitetin ekonomik, dhe si të tilla lejohen dhe janë të ligjshme për shkak të mbrojtjes së interesit publik.</p> <p>5. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në ushtrimin e funksionit të tij zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përveç në rastet kur me Ligjin nr. 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe plotësim ndryshimin e tij përcakton ndryshe.</p> <p>6. Ligji nr. 06/L-010 për Noterinë, neni 8 paragrafi 3,4 dhe 5 rregullon numrin dhe kompetencat territoriale të noterëve të certifikuar nga Ministria e Drejtësisë ku thuhet se <i>Numrin e noterëve dhe selive të noterëve e përcakton Ministri, me vendim ashtu që për territorin e një komune përcaktohet së paku një (1) noter. Përjashtimisht nga paragrafi 3. i këtij neni numri i vendeve të noterëve mund të rritet me vendim të Ministrit, ashtu që për çdo dhjetëmijë (10,000) banor përcaktohet nga një(1) vend i noterit, duke marr parasysh numrin e dokumenteve që procedohen nga zyrat e noterëve gjatë tërë vitit. Përjashtimisht nga paragrafi 3. i këtij neni në dy (2) apo më shumë komuna të cilat kanë numrin më të vogël të banorëve se sa numri që është përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni mund të kenë një(1) noter</i></p>
--	--	---

		<p>7. Pas shqyrtimit të kërkesës me nr. prot.220/20-01/H dhe pas analizimit të lëndës nga të dhënat dhe dokumentacioni në dispozicion dhe bazuar në listën e noterëve të cilët veprojnë në territorin e Kosovës, aktualisht në Komunën e Lipjanit ushtrojnë veprimtarinë e tyre 3 noter dhe në Komunën e Ferizajt ushtrojnë veprimtarin e tyre 4 noter.</p> <p>8. Sipas evidencës vlerësojmë se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, me nr. Prot. 220/20-01/H për anulimin e konkursit nga Ministria e sipas të dhënave dhe cilësimit të kësaj sjellje në treg, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.</p>
Rasti 2	<p>15.10.2020 - Konkluzion per GAP kunder BQK-se rreth rritjes se tarifave te TPL-se  <i>“Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente për Fillimin e Procedurës Hetimore ndaj Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës”</i></p>	<p>1. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës zhvillimin e procedurës e bazon tek neni 34 - Iniciativa për Fillimin i Procedurës dhe ex-officio neni 35 - Fillimi i Procedurës, dhe atë në rastet kur kemi të bëjmë me të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit te konkurrencës nga ana e ndërmarrjeve që operojnë në tregjet përkatëse. Neni 2 i Ligjit Nr. 04/L-226 për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës e definojnë përkufizimin Ndërmarrje sipas të drejtës së konkurrencës, si vijon:</p> <p>2. <i>“Ndërmarrje - çdo aktivitet biznesor pavarësisht mënyrës së organizimit ose formës së menaxhimit, ndërmarrësi publike e themeluar për kryerjen e aktiviteteve për interes publik si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik apo autoritet shtetëror që kryen aktivitet ekonomik pavarësisht se a konsiderohet apo jo subjekt afarist.”</i></p> <p>3. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese dhe sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 2, nuk konsiderohet ndërmarrje që kryen aktivitet ekonomik.</p>

		<p>4. Bazuar në Ligjin 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, BQK-ja është ekskluzivisht përgjegjëse për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare përfshirë edhe siguruesit. Parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve janë të përcaktuara me ligjin nr. 05/L-045 për sigurimet, ku përcaktohen se veprimtaria e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe sigurimet tjera të detyrueshme rregullohen me ligje të veçanta andaj Ligji 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia është ligj që rregullon sigurimet e detyrueshme në vend. Në zbatim të nenit 8 të këtij ligji, BQK ka nxjerrë rregulloren për caktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, me c rast përcakton strukturën e primit që siguruesit duhet të zbatojnë në caktimin e primit për sigurimin e detyrueshëm si dhe procedurat dhe afatet për miratim nga BQK-ja.</p> <p>5. Ju njoftojmë se nga ana e Rregullatorit të tregut të sigurimeve, pra, Bankës Qendrore të Kosovës, kemi pranuar një kërkesë më 09.08.2019 lidhur me shqyrtimin e çështjes së ndryshimit të tarifave për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia për dhënie të Mendimit Profesional sipas nenit 23 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Ju njoftojmë se Autoriteti është i autorizuar që me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, të organeve qendrore të administratës publike, personave juridikë me autoritet publik dhe organeve lokale të ofrojë Mendime Profesionale për veprimet që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut:</p> <p><i>Neni 23 Dhënia e Mendimit Profesional</i></p> <p>6. <i>Autoriteti, me kërkesë të Kuvendit, Qeverisë së Republikës së Kosovës, të organeve qendrore të administratës publike, personave juridikë me autoritet publik dhe organeve lokale jep mendime profesionale për ligjet, rregulloret dhe</i></p>
--	--	--

		<p><i>aktet tjera nënligjore që ndikojnë ndjeshëm në konkurrencën e tregut.</i></p> <p>7. Autoriteti, mund organeve të referuara në paragrafin 1. të këtij neni, t'u japë mendim për pajtueshmërinë e ligjeve ekzistuese dhe rregullave tjera me këtë ligj, ofron mendime me të cilat nxitë njohjen për konkurrencën e tregut, respektivisht ngritë nivelin e vetëdijesimit dhe informimit për rolin e ligjit dhe politikën e konkurrencës së tregut, si dhe ofron mendime dhe opinione profesionale për zgjidhjen dhe zhvillimet krahasuese të praktikave në fushën e legjislacionit dhe politikat e konkurrencës tregtare, për shqyrtimin e çështjes se ndryshimit të tarifave për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.</p> <p>8. Më 12.09.2019, AKK ka miratuar Mendimin Profesional duke e trajtuar kërkesën e BQK-së bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, (shih në vegëz dokumentin në fjalë:  <a href="https://ak.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Mendimi%20Profesional%20drejtuar%20BQK.pdf">https://ak.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Mendimi%20Profesional%20drejtuar%20BQK.pdf</a>) ku janë ofruar sqarime lidhur me sjelljet e kompanive të sigurimit, çmimet e primit të TPL-së, procesin e përlllogaritjes /përcaktimit të primeve.</p> <p>a. Ju njoftojmë se Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës më 05.02.2020 ka autorizuar Departamentin për Mbikëqyrjen e Tregut që të sigurojë të dhënat e nevojshme për tregun e sigurimeve, qëllimi i të cilave është analiza e kushteve të konkurrencës për produktin e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia (TPL), për kompanitë të cilat operojnë në tregun e sigurimeve në Republikën e Kosovës.</p> <p>9. Qëllimi i këtij shqyrtimi paraprak/monitorimi ka qenë që të njoftohemi mbi funksionimin e këtij tregu, strukturën e tregut dhe pjesëmarrësit në tregun përkatës, fuqinë përkatëse si dhe një pamje të situatës, fenomeneve dhe dobësitë e mundshme të tregut që në raste të</p>
--	--	---

		<p>caktuara mund të bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.</p> <p>10. Autoriteti i Konkurrencës i ka rekomanduar BQK-së (si rregullator i këtij tregu) që të fillohen përgatitjet që nga rregullimi i tanishëm i këtij tregu, të kalohet në tregun e rregulluar me një sërë tarifash të lejuara (tavan dhe dysHEME) e pastaj gradualisht të kalohet në çmimet e tregut plotësisht të liberalizuar. Gjithashtu kemi nënvizuar nevojën që në tregun përkatës të mos ketë çmime të unifikuara të Primit të TPL-së dhe kështu t'i hapet rrugë presionit konkurrues ndërmjet kompanive që operojnë në këtë treg.</p> <p>a. Më 24.09.2020 është zhvilluar një takim mes dy institucioneve, ku janë paraqitur masat e ndërmarra për zhvillimin e industrisë së sigurimeve në Kosovë. BQK është zotuar se ka ndërmarrë përgatitjet e nevojshme duke arritur në konkluzionin se modeli i çmimeve për produktet e detyrueshme duhet të avancohet në mënyrë që të sigurojë mbulimin e rrezikut potencial për çdo të siguruar dhe, në të njëjtën kohë, të lejoj variacion në kosto duke u bazuar në karakteristikat individuale për sa i përket riskut të të siguruarit. Pra çmime të përcaktuara nga tregu dhe risku.</p> <p>11. Si rezultat i bashkëpunimit ndër-institucional, është konkluduar se modeli i kostimit të policave të detyrueshme duhet të jetë i bazuar në riskun individual të të siguruarit, dhe që në një periudhë afatshkurtër të lëvizim nga modeli i cili ka qenë në aplikim për një periudhë rreth 20 vjeçare, në një model i cili mund të konsiderohet si model liberal i kostimit, duke respektuar faktorët individual të riskut sigures.</p> <p>12. Andaj, nga ajo që u tha më lart, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës vlerëson se nuk ka argumente për fillimin e procedurës</p>
--	--	--

		hetimore dhe u vendos si në dispozitiv të këtij konkluzioni.
Rasti 3	<p>06.05.2020 - Vendimi Final për kompaninë Kastrati Group SHPK.</p> <p><i>“I. Mbyllet procedura hetimore ndaj ndërmarrjes KASTRATI GROUP Shpk</i></p> <p><i>II. Gjatë procedurës hetimore është konstatuar se ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk nuk ka çrregulluar konkurrencën tregtare, në pajtim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, nenin 4 “Marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar”, paragrafi 1 nën paragrafi (1.1). III. KONSTATOHET se ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg individuale apo kolektive përkatësisht nuk ka shkelje ligjore sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.”</i></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për të konstatuar Marrëveshjen e ndaluar apo praktikën e bashkërenduar, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe neni 4 par.1 pika 1.1 dhe nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi: “Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën”.</li> <li>2. Duke u bazuar në plotësim ndryshim e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës - Marrëveshje është marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.</li> <li>3. Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Praktika e bashkërenduar është një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal në mes të dy ose më shumë ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale.</li> <li>4. Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, në mbështetje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 66 si dhe në mbështetje të punimit “Ekonomia në Marrëveshjet e heshtura” 1 (The Economics of Tacit Collusion) e përgatitur për Drejtorinë Gjenerale për Konkurrencë e BE-së (DG Competition) jep këtë sqarim dhe përcaktim për Marrëveshjet e heshtura: a. Marrëveshjet e heshtura - i. Koluzioni i heshtur, nuk do të thotë detyrimisht involvimi në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvimi i palëve për t’u marrur vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur sepse rezultati (në terma të caktimit të çmimit apo të sasisë së prodhuar) mund të ngjasojë me MARRËVESHJE EKSPLICITE apo edhe të një KARTELI ZYRTAR. ii. Koluzioni apo marrëveshje e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të fitojnë fitime ekstra-normale, ku fitimet "normale" korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur mund të lindë kur firmat bashkëveprojnë në mënyrë të përsëritur. iii. Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmime më të larta duke</li> </ol>



		<p>rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e koluzionit do të shkaktonte një hakmarrje. iv. Hakmarrja i referohet reagimit të firmave ndaj një devijimi nga rruga kolusive. Për të qenë efektiv, hakmarrja duhet të nënkuptojë një humbje të konsiderueshme fitimi për firmën devijuese, krahasuar me fitimin që do të kishte fituar duke iu përmbajtur rrugës koluzive apo marrëveshjes së heshtur.</p> <p>5. Në mungesë të provave për të dëshmuar marrëveshjen ose praktikën e bashkërenduar të ndërmarrjes KASTRATI GROUP Shpk, Autoriteti ka përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen dhe ka përdorur çdo mjet prove të paraparë me ligj për të dëshmuar mbi bashkëpunimin e ndërmarrjeve. Autoriteti gjatë vlerësimit të fakteve ka konstatuar rëndësinë e dokumentacionit të cilin e ka analizuar dhe vlerësuar me të gjitha të dhënat nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se nuk ka argumente për të vazhduar edhe më tutje procedurën hetimore.</p> <p>6. Nga se nuk kemi arritur të dëshmojmë se ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk ka ngritur ose ulur çmimet e derivateve të naftës me shumicë dhe pakicë gjatë vitit 2018 me ndërmarrjet tjera nën hetim në tregun përkatës, sepse ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk nuk ka pas shitje me pakicë gjatë tërë vitit 2018 përveç importit me shumicë dhe shitje me shumicë. Me që rast, në shitjet me shumicë nuk kemi evidentuar ndonjë sjellje të ndërmarrjes që korrespondon në koordinim me ndërmarrjet tjera.</p> <p>7. Pretendimet tona mbi bazën e së cilës kemi ngritur Konkluzionin Nr. 01/19 i dt. 15 shkurt 2018 për fillimin e procedurës hetimore nuk kemi arritur ta dëshmojmë qartësisht me prova bindëse. Në kuadër të kësaj kemi konstatuar se ndërmarrja nën hetim nuk ka shitur derivate me pakicë në tregun relevant. Nga analiza e të dhënave që janë përpunuar nga Autoriteti rezulton se ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk gjatë kësaj periudhe nuk ka shitur derivate me pakicë dhe si pasojë nuk ka pas ndonjë intencë mbi praktiken e bashkërenduar, sjellje paralele apo marrëveshjes së heshtur</p>
--	--	---

		<p>për çmimet me pakicë të derivateve me ndërmarrjet tjera.</p> <p>8. Gjatë analizës së dokumentacionit në procedurën hetimore, Autoriteti nuk ka gjetur dëshmi se ndërmarrja nën hetim ka shkelur nenin 4. paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës.</p> <p>9. Gjatë procedurës hetimore në tregun përkatës lidhur me rastin, takimeve të zhvilluara me palët të cilët janë të ndërlidhur me çështjen, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara nga institucionet relevante është konstatuar se ndërmarrja KASTRATI GROUP Shpk ka importuar dhe shitur derivate të naftës në tregun relevant vetëm me shumicë dhe bazuar mbi këtë nuk kemi arritur të provojmë me ndonjë fakt se ajo ka caktuar çmimet e derivateve me shumicë me ndërmarrjet tjera nën hetim.</p>
Rasti 4	<p>06.05.2020 - Vendimi Final për kompaninë Blu OIL SHPK.  <i>“Mbyllet procedura hetimore ndaj ndërmarrjes Blu OIL Shpk. II. Gjatë procedurës hetimore është konstatuar se ndërmarrja BLU OIL Shpk nuk ka çrregulluar konkurrencën tregtare, në pajtim të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 03/L-229, nenin 4 “Marrëveshje të ndaluar apo praktikë e bashkërenduar”, paragrafi 1 nën paragrafi (1.1). III. KONSTATOHET se ndërmarrja BLU OIL Shpk nuk ka abuzuar me pozitën dominuese në treg individuale apo kolektive përkatësisht nuk ka shkelje ligjore sipas nenit 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.”</i></p>	<p>1. Për të konstatuar Marrëveshjen e ndaluar apo praktikën e bashkërenduar, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe neni 4 par.1 pika 1.1 dhe nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi: “Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën”. 2. Duke u bazuar në plotësim ndryshim e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës - Marrëveshje është marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut. 3. Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Praktika e bashkërenduar është një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal në mes të dy ose më shumë ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale. 4. Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, në mbështetje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 66 si dhe në mbështetje të punimit “Ekonomia në Marrëveshjet e heshtura” 1 (The Economics of Tacit Collusion) e përgatitur për Drejtorinë Gjenerale për Konkurrencë e BE-së (DG Competition) jep këtë sqarim dhe përcaktim për Marrëveshjet e heshtura: a. Marrëveshjet e heshtura - i. Koluzioni i heshtur,</p>

		<p>nuk do të thotë detyrimisht involvimi në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvimi i palëve për t'u marrur vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur sepse rezultati (në terma të caktimit të çmimit apo të sasisë së prodhuar) mund të ngjasojë me MARRËVESHJE EKSPLOCITE apo edhe të një KARTELI ZYRTAR. ii. Koluzioni apo marrëveshje e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të fitojnë fitime ekstra-normale, ku fitimet "normale" korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur mund të lindë kur firmat bashkëveprojnë në mënyrë të përsëritur. iii. Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmime më të larta duke rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e koluzionit do të shkaktonte një hakmarrje. iv. Hakmarrja i referohet reagimit të firmave ndaj një devijimi nga rruga kolusive. Për të qenë efektiv, hakmarrja duhet të nënkuptojë një humbje të konsiderueshme fitimi për firmën devijuese, krahasuar me fitimin që do të kishte fituar duke iu përmbajtur rrugës koluzive apo marrëveshjes së heshtur.</p> <p>5. Në mungesë të provave për të dëshmuar marrëveshjen ose praktikën e bashkërenduar të ndërmarrjes BLU OIL Shpk, Autoriteti ka përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen dhe ka përdorur çdo mjet prove të paraparë me ligj për të dëshmuar mbi bashkëpunimin e ndërmarrjeve. Autoriteti gjatë vlerësimit të fakteve ka konstatuar rëndësinë e dokumentacionit të cilin e ka analizuar dhe vlerësuar me të gjitha të dhënat nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se nuk ka argumente për të vazhduar edhe më tutje procedurën hetimore. 6. Nga se nuk kemi arritur të dëshmojmë se ndërmarrja BLU OIL Shpk ka ngritur ose ulur çmimet e derivateve të naftës me shumicë dhe pakicë gjatë vitit 2018 me ndërmarrjet tjera nën hetim në tregun përkatës, sepse ndërmarrja BLU OIL Shpk nuk ka pas shitje me pakicë gjatë tërë vitit 2018 përveç importit me shumicë dhe shitje me shumicë. Me që rast, në shitjet me shumicë nuk kemi evidentuar ndonjë sjellje të ndërmarrjes që korrespondon në koordinim me ndërmarrjet tjera. 7. Pretendimet tona mbi bazën e së cilës kemi ngritur Konkluzionin Nr. 01/19 i dt. 15 shkurt 2018 për fillimin e procedurës hetimore nuk kemi arritur ta dëshmojmë qartësisht me prova bindëse. Në kuadër të kësaj kemi</p>
--	--	--

		<p>konstatuar se ndërmarrja nën hetim nuk ka shitur derivate me pakicë në tregun relevant. Nga analiza e të dhënave që janë përpunuar nga Autoriteti rezulton se ndërmarrja BLU OIL Shpk gjatë kësaj periudhe nuk ka shitur derivate me pakicë dhe si pasojë nuk ka pas ndonjë intencë mbi praktiken e bashkërenduar, sjellje paralele apo marrëveshjes së heshtur për çmimet me pakicë të derivateve me ndërmarrjet tjera. 8. Gjatë analizës së dokumentacionit në procedurën hetimore, Autoriteti nuk ka gjetur dëshmi se ndërmarrja nën hetim ka shkelur nenin 4. paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-226, për Mbrojtjen e Konkurrencës. 9. Gjatë procedurës hetimore në tregun përkatës lidhur me rastin, takimeve të zhvilluara me palët të cilët janë të ndërlidhur me çështjen, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara nga institucionet relevante është konstatuar se ndërmarrja BLU OIL Shpk ka importuar dhe shitur derivate të naftës në tregun relevant vetëm me shumicë dhe bazuar mbi këtë nuk kemi arritur të provojmë me ndonjë fakt se ajo ka caktuar çmimet e derivateve me shumicë me ndërmarrjet tjera nën hetim.</p>
Rasti 5	<p>06.05.2020 - Me Vendimi Final Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, ka shqiptuar sanksion administrative ndaj ketyre ndermarrjeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. N.P.T IBRAHIMI</li> <li>2. PATRONI Shpk</li> <li>3. VEDA -2 PETROLL Shpk</li> <li>4. ALBA PETROL GROUP Shpk</li> <li>5. LAB - OIL Shpk</li> <li>6. BENITA COMPANY Shpk</li> <li>7. N.P.T. FAT OIL</li> <li>8. PETROL OTI SLOVENIJA L.L.C</li> <li>9. PETROL COMPANY Shpk</li> <li>10. ALFA TRADE Shpk</li> <li>11. IP - KOS Shpk</li> <li>12. EX FIS Shpk</li> <li>13. AL- PETROL Shpk</li> <li>14. HIB PETROL Shpk</li> </ol>	<p>Ne vlere prej € 4,040,450.78 jane denuar 14 ndermarrje për arsye se:</p> <p>Për të konstatuar Marrëveshjen e ndaluar apo praktiken e bashkërenduar, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është bazuar në nenin 3 par.1.2 si dhe neni 4 par.1 pika 1.1 dhe nenin 66 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës citoi: <i>“Zbatimi i këtij Ligji duhet të jetë në pajtim me direktivat e Bashkimit Evropian për Konkurrencën”</i>.</p> <p>Duke u bazuar në plotësim ndryshim e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës - Marrëveshje është: çdo formë, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikën e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, ose në nivele të ndryshme, të tregut.</p> <p>Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, <i>Praktika e bashkërenduar</i> është një aktivitet që ka të bëjë me bashkëpunimin joformal në mes të dy ose më shumë</p>

		<p>ndërmarrjeve dhe që nuk bazohet në një vendim ose marrëveshje formale.</p> <p>Komisioni i Autoritetit Kosovar i Konkurrencës, në mbështje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 66 si dhe në mbështetje të punimit “<i>Ekonomia në Marrveshjet e heshtura</i>”<sup>1</sup> (<i>The Economics of Tacit Collusion</i>) e pregatitur për DG Competition jep këtë shqarim dhe përcaktim për <i>Marrëveshjet e heshtura</i>:</p> <p style="text-align: center;">a. Marrëveshjet e heshtura -</p> <p>Koluzioni i heshtur, nuk do të thotë detyrimisht involvimi në ndonjë marrëveshje të heshtur apo involvimi i palëve për t’u marrur vesh apo komunikuar. Por ju referohet marrëveshjes së heshtur sepse rezultati (në terma të caktimit të cmimit apo të sasisë së prodhuar) mund të ngjasojë me MARREVESHJE EKSPLOCITE apo edhe të një KARTELI ZYRTAR.</p> <p>Koluzioni apo marrëveshje e heshtur është një sjellje e tregut që u mundëson firmave të realizojnë fitime ekstra-normale, ku fitimet "normale" korrespondojnë me situatën e ekuilibrit. Marrëveshja e heshtur mund të lindë kur firmat bashkeveprojnë në mënyrë të përsëritur.</p> <p>Atëherë ato mund të jenë në gjendje të ruajnë çmime më të larta duke rënë dakord në heshtje se çdo devijim nga rruga e koluzionit do të shkaktonte një hakmarrje.</p> <p>Hakmarrja i referohet reagimit të firmave ndaj një devijimi nga rruga kolusive. Për të qenë efektiv, hakmarrja duhet të nënkuptojë një humbje të konsiderueshme fitimi për firmën devijuese, krahasuar me fitimin që do të kishte fituar duke iu përmbajtur rrugës koluzive apo marrëveshjes së heshtur.</p> <p>Meqënëse barra e proves bie mbi Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, Autoriteti e ka provuar se ka pasur Marrëveshje të bashkërenduar, rrjedhimisht marrëveshje të heshtur ndërmjet ndërmarrjeve në procedurë nëpër mjet analizave ekonomike dhe statistikore. Më poshtë është linku, ku të gjitha</p>
--	--	--

<sup>1</sup> [https://ec.europa.eu/competition/mergers/studies\\_reports/the\\_economics\\_of\\_tacit\\_collusion\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/competition/mergers/studies_reports/the_economics_of_tacit_collusion_en.pdf)

		vendimet janë të publikuara në wefaqen e AKK-së. <a href="https://ak.rks-gov.net/vendimet">https://ak.rks-gov.net/vendimet</a>
--	--	---

## 2. POZITA DOMINUESE

Rasti 1	<p>16.11.2020 - Konkluzion për mos fillim të procedurës hetimore.</p> <p><i>“Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit të situatës në tregun relevant, bazuar në dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, konstatojmë se nuk ka argumente për fillimin e procedurës hetimore ndaj kompanisë SharrCem Sh.P.K adresa: Adem Jashari 280 71510 Hani i Elezit, lidhur me pretendimet për çmime abuzive”.</i></p>	<p>Autoriteti Kosovar i Konkurrencës bazuar në nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës ka monitoruar kompaninë SharrCem SH.P.K për shkak të shqetësimeve të ngritura nga lidhur me pretendimin për keqpërdorim të pozitës dominuese për shkak se kompania SharrCem SH.P.K kishte ngritur çmimin e çimentos. AKK ka nxjerrë strukturën e tregut të kësaj kompanie, në bazë të analizave del se kompania SharrCem SH.P.K ka këtë strukturë të tregut: për vitin 2018 ka pozitë dominuese përafërsisht _____% për vitin 2019, _____% ndërsa deri më 30.06.2020, përafërsisht rreth _____%. 2. Lidhur me pretendimet e _____ se kompania SharrCem Sh.P.K ka keqpërdor pozitën dominuese lidhur me ngritjen e çmimeve të çimentos, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka monitoruar sjelljen e kësaj kompanie në treg nga këndvështrimi e rregullave të konkurrencës konkretisht lidhur me çmimet e tepruara (excessive prices), duke e marrë parasysh çmimet e prodhimit dhe importit me çmimet e rajonit. Lidhur me ngritjen e çmimeve të prodhuesit vendor kompania SharrCem Sh.P.K ndërmjet viteve 2018-2019 kishte pasur ngritje të çmimeve përafërsisht _____% ndërsa krahasimi ndërmjet viteve 2019 - deri me 30.06.2022 ka pasur ngritje përafërsisht _____%. kjo ngritje e çmimeve kishte ndodhur edhe në rajone. Kompania prodhuese SharrCem” Sh.P.K posedon kontratë për shtijën e produkteve të çimentos me klientët, në nenin 3 të kontratës i referohet njoftimit të secilit blerës në lidhje me çfarëdo ndryshimi të çmimit. Neni 3 i kontratës është si në vijim: 3. Neni 3 i kontratës është si në vijim: “Sasia e kontraktuar sipas Nenit 1 të kësaj Kontratë mund t’i shitet Blerësit nga Shitësi sipas çmimeve që janë në fuqi në datën kur produktet i dorëzohen Blerësit. Shitësi duhet të informojë Blerësin, sipas kërkesës së Blerësit, mbi çmimet që janë në fuqi në momentin kur Blerësi shpreh interesimin për të blerë produktet sipas kësaj Kontrate. Për shmangien e çfarëdo dyshimi, Shitësi nuk ndërmerr asnjë detyrim për t’i shitur Blerësit çfarëdo sasia minimale të produkteve të</p>
---------	---	---

		<p>Shitësit me çmimet që janë në fuqi në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.” 4. Duke u bazuar në nenin 3 të kontratës së cekur më lartë Fabrika e Çimentos SharrCem” Sh.P.K me datën 30.12.2019, ka njoftuar klientët me çmimet e reja që do të hyjnë në fuqi nga data 13.01.2020. 4 5. Çmimet e kompanisë SharrCem SH.P.K kanë qenë transparente, klientët i kishte njoftuar për ndryshimin e çmimeve, blerësit kanë pas mundësi zgjedhje te kompanitë tjera të cilat importojnë dhe shesin produktet e çimentos të cilat janë për afërsisht ____ kompani, konkurrenca në këtë treg është e përqendruar në shumë kompani, kompania SharrCem SH.P.K nuk i ka kapacitetet t’i mbuloj nevojat e çimentos në Kosovë për faktin se kapaciteti i saj është i limituar dhe se i mbulon nevojat e konsumit të tregut të Kosovës me rreth ____% të furnizimit. 6. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë monitorimit të kompanisë SharrCem SH.P.K nuk gjeti se çmimet e çimentos të vendosura janë abuzive për faktin se: nëse i krahasojmë çmimet e prodhimit vendor dhe vendet e rajonit, në Kosovë çmimet janë për afërsisht të njëjta apo më të ulëta se çmimet e rajonit, kemi një dallim të vogël në çmime. Nuk ka pas ulje të prodhimit, nuk ka pas zvogëlim të ofertës, uljes së kualitetit të produktit e që çmimet janë në raport të arsyeshëm me vlerën ekonomike të produktit.</p>
Rasti 2	<p>4.12.2020- Konkluzion per fillim te hetimit kundrejt KEDS dhe KESCO.  <i>“Për fillimin e procedurës hetimore ndaj ndërmarrjeve KEDS Sh.a. me NUI: 810799364 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5 dhe KESCO Sh.a. me NUI: 811288887 me adresë: Prishtinë, Bill Clinton Boulevard Nr. 5, për shkak të dyshimeve të bazuara për arritjen e Marrëveshjes së ndaluar apo praktikë të bashkërenduar si dhe Abuzim me Pozitën Dominuese, e ndaluar dhe e ndëshkuar sipas Ligjit për Mbrojtjen Konkurrencës neni 4 dhe 11”.</i></p>	<p>Gjatë shqyrtimit paraprak të hetimit në tregun e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Kosovës, Autoriteti ka konsultuar dokumente të shumta rreth funksionimit dhe operimit të këtij tregu. Ka analizuar me kujdes bazën ligjore të funksionimit të sektorit të energjisë elektrike dhe në dritën e kësaj ka grumbulluar dëshmi dhe dokumente të vlefshme, ka zhvilluar intervista dhe biseda me akterë të ndryshëm të shoqërisë, me qëllimin e vetëm, që t’i forcojë dyshimet e veta mbi shkeljet potenciale që palet në procedurë i kanë bërë në këtë treg.</p> <p>Dyshimet e bazuara të Autoritetit janë se ndërmarrja KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. kanë abuzuar me pozitën e tyre dominuese në treg dhe kanë arritur marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar duke rënë ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përkatësisht nenin 4 dhe 11.</p> <p>Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike ka vërejtur se pala në</p>

		<p>procedurë KEDS sh.a. ka abuzuar me pozitën dominuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE)</li> <li>b) Duke kërkuar nga BRE-të por edhe investorët e tjerë, që në rastet kur ata bëjnë investime në trafo-stacione, ato investime dhe prona ku gjendet trafo-stacioni të barten në pronësi të ndërmarrjes KEDS sh.a.</li> <li>c) Duke vendosur kufizime në pajisje apo produkte që nevojiten për t'u kyçur në sistemin e shpërndarjes, duke kërkuar nga investitori që të gjitha pajisjet që nevojiten që instalohen të jenë të një marke të pranueshme për KEDS sh.a. si dhe të kenë teste të tipit të duhur sipas procedurave të brendshme të KEDS sh.a.</li> </ul> <p>Autoriteti gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun e energjisë elektrike gjithashtu ka vërejtur se palët në procedurë KEDS sh.a. dhe KESCO sh.a. kanë arritur Marrëveshje të ndaluar apo praktikë të bashkërenduar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Duke krijuar pengesa për hyrje në treg ndaj operatorëve të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) dhe investorëve tjerë, në atë mënyrë që: <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Ka shfrytëzuar të njejtin objekt</li> <li>ii. Ka shfrytëzuar ekspertët e njejtë</li> <li>iii. Ka mbajtur kontabilitetin e përbashkët nga e njejta zyre</li> <li>iv. Ka bërë shkëmbimin e informacioneve.</li> </ul> </li> </ul> <p>Se çfarë u tha në pikën 4, ndërmarrja KEDS sh.a në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthort kanë vendosur çmimin jo real të blerjes apo shitjes, ose kushte tjera të pa drejta tregtare, kanë zbatuar kushte të ndryshme të transaksioneve për punët e njëjta me ndërmarrjet tjera duke i sjellë ato në një pozitë të pafavorshme në raport me konkurrencën dhe kanë vendosur çmime ose e kushte tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjes jashtë tregut relevant të konkurrentëve të veçantë ose të një produkti të tyre.</p> <p>Se çfarë u tha në pikën 5 ndërmarrjet KEDS sh.a.dhe KESCO sh.a. kanë arritur marrëveshje të</p>
--	--	--



		ndaluar apo praktikë të bashkërenduar në atë mënyrë që: kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese; kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë që për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave.
--	--	---

### 3. PËRQENDRIMET

Rasti 1	17.11.2020 Vendim për LEJIMIN e perqendrimit Euroimpex d.o.o dhe mbi " Opel Automotive S d.o.o"	<p><b>LEJOHET</b>, Përqendrimi i ndërmarrjeve nga dhe ndërmjet Euroimpex d.o.o, dhe mbi "Opel Automotive S d.o.o për blerjen e 100% të kuotave, Euroimpex d.o.o është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas dhe që ekziston sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 4135059, me seli në adresën 72 Bulevar treta makedonska brigade Shkup.</p> <p>Southeast Europe LLC është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 13-09-087612, e themeluar dhe që ekziston sipas legjislacionit të Hungarisë, me seli në dhe adresë H-2040 Budaors Szabadsat ut 117 Hungari. Opel Automotive S d.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar me Nr. të regjistrimit 211598232, e themeluar dhe që ekziston sipas legjislacionit të Serbisë, me adresë Vladimira Popovica 6, floor 1, number A 105-2 Beograd i Ri, Serbi. Në tregjet e jashtme, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës Euroimpexd.o.o, dhe Southeast Europe LLC, nuk ka filiale të regjistruara por veprojnë vetëm përmes shitjeve.</p>
Rasti 2	05.11.2020 Vendim per perqendrim mes Diagnostični ct. Vila Bogatin dhe "Ampelus Holding Limited	<p><b>LEJOHET</b>, Përqendrimi i ndërmarrjeve nga/dhe ndërmjet Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o.( blerësi ) dhe "Ampelus Holding Limited ( shitësi ), për blerjen e 100% të aksioneve. Diagnostični center Vila Bogatin d.o.o shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Bled dhe adresë biznesi në Pod Skalo 4, 4260, Bled, e regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5690366000. Vila Bogatin ka pronar ZTSR Dejavnost Holdingov d.o.o. me 100% të aksioneve, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me 50% të aksioneve të së cilës është pronar Pozavarovalnica</p>

		<p>Sava , d.d (Sava e Re) , ndërsa 50% të tjera i takojnë Zavarovalnica Triglav, d.d.(Triglav). Kirurski Santorij Rozna Dolina d,o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë bizensi në Rozna Dolica , cesta IV 45,1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 5966809000 (“ Kiruski sanatorij “ ose Shoqëria’) ka pronar Ampelus Holding Limited me 100% të akisoneve.</p> <p>Ampelus Holding, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e rregulluar sipas ligjeve të Qipros, me seli në Limasol dhe adresë biznesi në Arch. Makarios III ,5, 4000, Limasol Qipro, e regjistruar në regjistrin tregtar të Qipros me Nr. HE 156211. Ampelus Holding është pronare e 100% të aksioneve të Shoqërisë.</p>
Rasti 3	27.05.2020 - Vendimi i NLB dhe Komercijalna Banka	<p><b>LEJOHET</b>, Përqendrimi i ndërmarrjeve nga dhe ndërmjet Republikës së Serbisë e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Serbisë e cila mban aksione të rendomta në <b>Komercijalna Banka a.d. Beograd si shitëse</b> dhe <b>NLB si blerës</b> e te gjitha aksioneve të lartpermendura që Republika e Serbisë i mban në Target.</p> <p><b>Nova Ljubljanska Banka d.d. Lubljana <u>NLB</u></b> , është shoqëri aksionare, e themeluar dhe e rregulluar sipas ligjeve Sllovene, me seli në Lubljanë dhe adresë të biznesit në Trg Republika 2, 1000, Ljubljana, Slloveni e regjistruar në Regjistrin Slloven të Bizneseve me nr. 5860571000. NLB është kompani publike. Kapitali aksionar i emetuar i NLB është i ndarë në 20,000,000 aksione e cila perfaqëson grupin më të madh bankar dhe financiar në Slloveni. Me fokus strategjik në tregjet e zgjedhura në EJM, NLB GROUP përbëhet nga NLB d.d. si entiteti kryesor në Slloveni, gjashtë banka subsidiare në EJM, disa kompani për shërbime ndihmese (menaxhimi i aseteve, sigurimet, menaxhimi i pronës së paluajtshme etj) dhe një numer i kufizuar i filialeve jo-berthame në mbyllje të kontrolluar.</p> <p><b>NLB</b>, është banka më e madhe në Slloveni me 94 dege dhe 688,547 kliente aktive, me fokus</p>

		<p>strategjik në tregjet e zgjedhura në EJL. NLB është e pranishme në shtetet e EJL-se, si Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi. Në tregjet e jashtme, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës, NLB ka një filiale të regjistruar në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës të indentifikuar si NLB Banka Sh.A. Prishtinë, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), Me numër unik identifikues 810486250 dhe me seli në rr. Ukshin Hoti, nr, 124, 10000 Prishtinë, Kosovë në pronesi të NLB d.d. me 81.21% të kapitalit të paguar prej 41,652,000.00 Eur, dhe aksionare tjerë të vegjël.</p> <p><b>Komercijalna banka a.d. Beograd (Vracar)</b> është kompani aksionare e organizuar dhe ekziston në përputhje me ligjet e Republikës së Serbisë, e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimeve Tregtare me numër identifikimi 07737068, selia e regjistruar e së ciles është në Svetog Save 14, Beograd. Është banke që operton në Territorin e Serbisë ku ofron një game të plotë të shërbimeve bankare për të gjitha kategoritë e klienteve. Komercijalna Banka është kompani aksionare publike, e inkuorporuar me 25 Tetor 2001, me numrin e identifikimit 077370068. Aktiviteti kryesor i saj i regjistruar është 64.19 - Ndërmjetesim tjetër monetar. Në tregjet e jashtme, përkatësisht në territorin e Republikës së Kosovës, Komercijalna Banka a.d. ka një subsidiar të regjistruar në bazë të ligjeve të Kosovës në ARBK të identifikuar si Komercijalna Banka a.d. - Beograd - Filiali në Mitrovice, Dega e Kosovës me numer unik identifikues 810363292 dhe seli të regjistruar në Kralja Petra I 33, 40 000 Mitrovice Veriore( KB Dega e Kosovës). KB Dega e Kosovës përbehet nga 9 degë të cilat gjeografikisht janë të ndara në dy njesi: Lepasovic, Zubin Potok, Zvecan dhe Mitrovica, në veri të lumit Iber, dhe Gracanica, Ranillug, Shillove, Shterpce dhe Dragash që ndodhen në Jug të lumit Iber. Dega i ka 9 ATM.</p>
Rasti 4	03.02.2020 - Vendimi i SavaRe dhe NLB Vita - Web	<b>LEJOHET</b> , Përqendrimi i Sava d.d. dhe NLB Vita d.d., përmes blerjes së 100% të aksionëve me të cilin NLB dhe KBC shesin aksionet e tyre në

		<p>siguruesin e jetës tek Sava Re. Në një proces të përbashkët, Nova Ljubljanska banka ('NLB') dhe KBC Insurance NV ('KBC') kanë rënë dakord të shesin aksionet e tyre përkatëse në ndërmarrjen e përbashkët Sllovene të sigurimit të jetës NLB Vita te Sava Re, një nga tre grupet më të mëdha të sigurimeve në rajonin e Adria.</p> <p><b>Sava Re</b>, është shoqëri aksionare, me numër të regjistrimit të biznesit 5063825000, me numër identifikues të TVSH-së SI17986141 me adresë të regjistruar në Rruga Dunajska cesta 56 (p.p.b 318), 1001 Ljublanë ,Slloveni. Sava Re në territorin e Republikës së Kosovës ka në pronësi;</p> <p><b>Kompaninë e sigurimeve:</b></p> <p>a. <b>Illyria Sh.A.</b>, e cila është shoqëri aksionare me numër unik identifikues 810483769 dhe numër të regjistrimit të biznesit 70152892, me adresë të regjistruar në Sheshin Nëna Terezë Nr.33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jo-jetësor; dhe</p> <p>b. <b>Kompania për Sigurimin e Jetës Illyria -Life Sh.A.</b>, shoqëri aksionare me numër unik të identifikues 810733837 dhe numër të regjistrimit të biznesit 70520893 dhe me adresë të regjistruar në Sheshi Nëna Terezë Nr. 33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit sigurimin jetësor, si dhe <b>3. Illyria Hospital Sh.P.K.</b>, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër të regjistrimit të biznesit 70587513, me adresë të regjistruar në Sheshin Nëna Terezë Nr.33, 10000 Prishtinë, me aktivitete të biznesit; aktivitetet e mjeksisë së përgjithshme, tregtia me shumicë jo e specializuar, tregtia me pakicë e artikujve ortopedikë dhe mjeksorë, në dyqane të specializuara, aktivitetet e dentistëve, tregtia me pakicë e artikujve farmaceutik. Ndonëse aktivitetet e lartpërmendura janë të regjistruara si aktivitete të biznesit të Illyria Hospital Sh.P.K., për momentin Illyria Hospital, nuk kryen asnjë nga këto aktivitete në Kosovë.</p> <p>c. <b>NLB Vita d.d.</b>, është shoqëri aksionare e themeluar dhe e rregulluar sipas legjislacionit Slloven, me seli në Lubjanë dhe adresë bizensi në Trg republike 3, 1000 Lubjanë, regjistruar në regjistrin tregtar Slloven me Nr. 1834665000.</p>
Rasti 5	Data: 24.12.2020 - Vendimi i CZECH MEDIA INVEST a.s (CMI), Rockaway Capital SE (Rockaway), dhe Mergim Cahani ("Mr MC"). Gjirafa Tech	<b>LEJOHET</b> , Përqendrimi i realizuar, nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët (Joint Venture) Gjirafa Tech, një ndërmarrje me funksion të plotë e kontrolluar nga CZECH MEDIA INVEST a.s (CMI), Rockaway Capital SE (Rockaway), dhe Mergim Cahani ("Mr MC").

		<p>Gjirafa Tech është një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Republikën Çeke. Struktura e Gjirafa Tech do të jetë e tillë që Gjirafa dhe CMI të kenë në pronësi secila nga 50% të aksionëve. Gjirafa Tech, do të jetë aktiv në shitjen e produkteve të teknologjisë dhe shërbimeve të tjera të ngjashme në një bazë të softuerit si një shërbim (“SaaS”), dhe potencialisht, edhe shitjen e produkteve të teknologjisë në një infrastruktur si një shërbim (“IaaS”) dhe platformës si një shërbim (“PaaS”), (së bashku shërbime kompjuterike cloud) e fokusuar kryesisht në Republikën Çeke dhe Francë. Qëllimi përfundimtar është që Gjirafa Tech të shesë shërbime të paketuara SaaS në CMI dhe palëve të treta.</p> <p><b>CZECH MEDIA INVEST a.s.</b> është shoqëri aksionare, me Nr. të biznesit 24817236, dhe adresë, Parizska 130/26 Josefov Prag 1, Republika Çeke. CMI është shoqëri mëmë e grupit privat të investimeve që përqendrohet për blerjen dhe adriministrimin e aseteve mediatike në Evropën Qëndrore dhe Perendimor. Rockaway Capital SE (Rockaway), është shoqëri Evropiane (Societas Europea) ,me Nr. të biznesit 01967631, dhe adresë, NA Hrebenche II 1718/8 Nusle 140 00 Prag 4, Republika Çeke. Rockaway është shoqëria mëmë e një grupi biznesi kryesisht aktiv në fushën e tregtisë elektronike, udhëtimeve elektronike, mediave, botimit të librave dhe kapitalit sipërmarrës, ( Rockaway Group).</p> <p><b>Z. Mergim Cahani (“Mr MC”)</b>, adresa e regjistruar, Fahredin Hoti, PN, Prizren, 20000, Kosovë. Z. MC është person fizik që kontrollon bashkërisht Gjirafën së bashku me Rockaway para përqendimit të propozuar. Z. MC është gjithashtu themeluesi dhe presidenti i Gjirafës (CEO). Gjirafa Kosovo LLC, është e regjistruar me Nr. të biznesit 810840307, dhe adresënë Magjistralen Prishtinë-Ferizaj, km 6-të, Graçanicë, Kosovë që operon në platformën e tregtisë elektronike në gjuhën shqipe që përmbledh lajmet nga mediat shqipfolëse dhe platforma VOD “Gjirafa Video”, u fokusua kryesisht në prodhimin lokal të medias në gjuhën shqipe.</p> <p><b>Targeti:</b> Gjirafa Tech është një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Republikën Çeke. Struktura e Gjirafa Tech do të jetë e tillë që Gjirafa dhe CMI të kenë në pronësi</p>
--	--	--

		secila nga 50% të aksionëve. Gjirafa Tech, do të jetë aktiv në shitjen e produkteve të teknologjisë dhe shërbimeve të tjera të ngjashme në një bazë të softuerit si një shërbim (“SaaS”), dhe potencialisht, edhe shitjen e produkteve të teknologjisë në një infrastruktur si një shërbim (“IaaS”) dhe platformës si një shërbim (“PaaS”), (së bashku shërbime kompjuterike cloud) e fokusuar kryesisht në Republikën Çeke dhe Francë. Qëllimi përfundimtar është që Gjirafa Tech të shesë shërbime të paketuara SaaS në CMI dhe palëve të treta. Targeti nuk ka degë të regjistruar në Republikën e Kosovës.
--	--	--

#### 4. MENDIMET PROFESIONALE

Rasti 1	<p>10.04.2020 - Rekomandim Qeverisë së Kosovës per vendimin nr.05/21</p> <p><b>AUTORITETI KOSOVAR I KONKURENCËS (tutje ref. AUTORITETI) vlerëson se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 dobëson presionin konkurrues i cili shpie në përforcimin e kompanisë ekzistuese.</b></p> <p><b>AUTORITETI konsideron se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 mund të shpie tek format e keqpërdorimit të pozitës dominuese nga Telekom i Kosovës.</b></p> <p><b>AUTORITETI vlerëson se Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 është në kundërshtim me ekonominë e tregut me konkurrencës të lirë.</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.04.2020 nr. 05/21 me të cilën përjashton Ligjin e Prokurimit Publik për shërbimet telekomunikuese që ofron Telekom i Kosoves, si shërbime me rëndësi të veçanta shtetërore, mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës përkatësisht neni 119 pika 3 citoj “Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.”</li> <li>- Me këtë vendim Qeveria e Kosovës i ka përjashtuar në tërësi ofertat që mund t’i ofrojnë ndërmarrjet për shërbime telekomunikuese, duke i përjashtuar procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik, dhe duke e bërë monopol natyror, “Telekomin e Kosovës”</li> <li>- Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 10: Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Si e tillë institucionet e shtetit e posaçërisht Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është i obliguar ta zbatojë këtë dispozitë kushtetuese dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.</li> <li>- Integrimi i Kosovës në BE dhe standardet që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian (Neni 101 i TFEU-së) që kërkohen të arrihen</li> </ul>
---------	--	--

		<p>në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, neni 74 dhe 75, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë hyrës potencial në “garë” për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues. Nga një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacione).</li> <li>- Aktet normative duhet t’i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha mundëson krijimit të ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.</li> <li>- Për më shumë, organet shtetërore në të gjitha nivelet në vend të njoftohen se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i obliguar sipas ligjit, që të jetë aktiv për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet nëse këto veprime kanë efekte në treg.</li> </ul>
Rasti 2	<p>22.10.2020 - M.P. per ZRRE rreth “VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREGUN E ENERJISË 2018-2019</p> <p>AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS (tutje ref. AUTORITETI) <b>konstaton</b> se dokumenti i ashtuquajtur “VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREGUN E ENERJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË2018-2019” në parim është në</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Me datën 27.08.2020 nëpërmes postës elektronike, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka pranuar kërkesën nga ZRRE, që ta analizoj dhe ta komentoj dokumentin e ashtuquajtur “VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREGUN E ENERJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË2018-2019” se a bie ndesh me politikat e Konkurrencës.</li> <li>- Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 10: Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Si e tillë institucionet e shtetit e posaçërisht Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, është i obliguar ta zbatojë këtë dispozitë</li> </ul>

	<p>përputhje me politikat e Konkurrencës.</p> <p>AUTORITETI <b>kërkon</b> nga ZRRE që pas licensimit të ndërmarrjeve përkatëse t'iu vendoset një afat kohorë për të filluar veprimtarinë ekonomike. Në të kundërtën nëse ndërmarrja e licensuar nuk ka filluar veprimtarinë ekonomike të përcaktuar në kohën e kërkuar, ZRRE t'ia revokojë apo t'ia marrë licensën.</p> <p>AUTORITETI <b>kërkon</b> nga ZRRE që të njoftohet për zbatimin e pikës së II të këtij dispozitivi.</p>	<p>kushtetuese dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës trajton 3 (tri) shtyllat kryesore të politikës së Konkurrencës: <ul style="list-style-type: none"> <li>o Marrëveshjet e Ndaluar (kartelet)</li> <li>o Abuzimi me Pozitën Dominuese</li> <li>o Përqendrimet apo Bashkimet e ndërmarrjeve.</li> </ul> </li> <li>- Integrimi i Kosovës në BE dhe standardet që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian (Neni 101 i TFEU-së) që kërkohen të arrihen në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, neni 74 dhe 75, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikat evropiane.</li> <li>- Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë hyrës potencial në “garë” për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues. Nga një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacione).</li> <li>- Aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha mundëson krijimit të ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.</li> <li>- Për më shumë, organet shtetërore në të gjitha nivelet në vend të njoftohen se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i obliguar sipas ligjit, që të jetë aktiv për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet nëse këto veprime kanë efekte në treg.</li> <li>- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka analizuar këtë dokument dhe konsideron se</li> </ul>
--	---	--



		<p>në parim ky dokument nuk bie ndesh me rregullat dhe politikat e Konkurrencës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjithashtu ka analizuar pjesën e licensimit të ndërmarrjeve nga ana e ZRRE-se dhe kërkon nga ZRRE që secilës licensë apo ndërmarrje t'iu vendoset një afat kohore për të filluar veprimtarinë e tyre ekonomike</li> </ul>
Rasti 3	<p>Spektori farmaceutik Me date 12.05.2020 kemi pranuar nje njoftim per AKK ne lidhje me moszbatimin e Mendimit Profesional me Nr. 20/19, nga Avokati i Popullit</p>	<p><b><i>Sqarimin qe jep AKK per Avokatin e Popullit lidhur me zbatimin e udhezimi administrativ eshte percaktimi dhe rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale</i></b></p> <p>Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është përcaktimi dhe rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale për shitje me shumicë dhe pakicë në sektorin privat nga subjektet e licencuara, produkteve medicinale nga Lista e Barnave Esenciale, dhe produkteve medicinale nga Lista e Barnave të Rimbursueshme nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor, kjo në përputhje me metodologjinë e përcaktuar.</p> <p>Në vitet e fundit autoritetet e konkurrencës dhe institucionet e tjera publike kanë trajtuar probleme në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Këto institucione kanë dhënë vlerësimet e konkurrencës, identifikuan nëse ekzistojnë arsyttime për çdo kufizim të konkurrencës dhe vlerësojnë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Ata gjithashtu bënë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë.</p> <p>Pas, fillimit të periudhës së implementimit të Udhëzimit Administrativ rreth unifikimit të çmimit të produkteve medicinale, Autoriteti i Konkurrencës do të trajtojë problemet nëse ato do të shfaqen në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Gjatë vlerësimit do të identifikohen nëse ekzistojnë arsyttime për çdo kufizim të konkurrencës dhe do të vlerësojmë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Ne gjithashtu do të bëjmë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë, ne bashkëpunim me palët e interesit.</p>

Rasti 4	<p>Sektori farmaceutik 12.05.2020, mbi Njoftimi për AKK në lidhje me moszbatimin të “Mendimit Profesional” me Nr.20/19</p>	<p>Shoqata e Distributorëve dhe Medicinal të Kosovës (SHDFMK) e ka kundërshtuar Ministrinë e Shëndetësisë se nuk është duke e zbatuar drejtë Mendimin Profesional të AKK-se mbi bazën e këtyre pretendimeve:</p> <p>Pas, fillimit të periudhës së implementimit të Udhëzimit Administrativ rreth unifikimit të çmimit të produkteve medicinale, Autoriteti i Konkurrencës do të trajtojë problemet nëse ato do të shfaqen në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Gjatë vlerësimit do të identifikohen nëse ekzistojnë arsye të çdo kufizim të konkurrencës dhe do të vlerësojmë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Ne gjithashtu do të bëjmë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë, në bashkëpunim me palët e interesit.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Në lidhje me pikën V nën-pika a - bazuar në praktikën evropiane vendosja e çmimeve fikse në produktet pa përshkrim (OTC).</li> </ol> <p><b>Përderisa Ligji për Produkte medicinale nuk ka bërë përjashtime, përkatësisht e ka pamundësuar që këto produkte të veçohen përkatësisht të mos e bëjnë rregullimin e këtyre.</b> Në situatën aktuale është paraparë rregullimi i çmimeve të produkteve medicinale, përkatësisht i të gjitha produkteve që posedojnë Autorizimin për Marketing duke përjashtuar këtu vetëm ato produkte të cilat nuk i nënshtrohen regjistrimit në Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Medicinale si shtesat ushqimore, produktet herbale, disa vitamina të cilat nuk regjistrohen etj. Autoriteti konsideron se me amendamentimin e Ligjit për produkte dhe Pajisje Medicinale kjo pikë të merret parasysh dhe të vlerësohet nga autoritetet për tu sqaruar dhe rregulluar me Ligj.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Në lidhje me pikën Pika V, nën-pika b - ministria duhet të aplikojë mekanizmat “Claw-back” atëherë kur çmimet e medikamenteve të rimbursueshme ulen ndërsa MSH e ka përjashtuar tërësisht këtë pikë dhe nuk ka krijuar asnjë kusht për zbatimin e saj.</li> </ol>
---------	--	--

		<p>Autoriteti i Konkurrencës ka paraparë që: “Ministria e Shëndetësisë duhet të aplikoj mekanizmat “Claw-Back”, atëherë kur çmimet e medikamenteve të rimbursueshme ulën.”, Në këtë rast konsiderojmë se me hartimin e rregulloreve nga Fondi për sigurim Shëndetësor <b>kjo pikë</b> duhet të merret parasysh për barnat që do të jenë në listën për rimbursim.</p> <p>3. Në lidhje me pjesën e arsytimit të mendimit profesional për kërkesat e parashtruara: <b>Pikat 1,2 dhe 3</b> të arsytimit ku përfshihen listat A, B dhe pasi pjesa e LBE B ende nuk është e rregulluar është parakusht për të mos e zbatuar këtë udhëzim.</p> <p>Udhëzimi ka përcaktuar metodologjinë dhe mënyrën se si bëhet përcaktimi i çmimit dhe kjo vlen për të gjitha produktet medicinale të cilat posedojnë regjistrimin. Kjo do të thotë se në momentin kur një produkt regjistrohet edhe i nënshtrohet mekanizmave të rregullimit të çmimit dhe pastaj ai mund të jetë pjesë e tregut të lirë, apo të bëhen furnizime në institucione publike apo private. Këtu nuk ka ndonjë pikë kundërshtuese dhe as përjashtuese përkundrazi konsiderohet se kjo është edhe një nga parakushtet të cilat është dashur të plotësohen në mënyrë që të fillojë procesi i rimbursimit. <b>Në mungesë të një rregullimi të tillë fondi për sigurim shëndetësor nuk mund të bëjë rimbursimin financiar rrjedhimisht nuk do të ishte funksional.</b></p> <p>4. Në lidhje me pjesën e arsytimit të mendimit profesional për kërkesat e parashtruara : <b>Pika 4</b> zgjidhje për shkak të interesit të shëndetit publik, e cila kundërshtohet me pretendimin se kompani me renome do të largohen nga Kosova.</p> <p>Kjo më shumë është çështje e sektorit farmaceutik megjithatë Autoriteti konsideron se kompanitë me renome pjesëmarrjen e tyre e kushtëzojnë kryesisht në bazë të tregjeve të rregulluara dhe përkundrazi nuk gjenden në tregje të cilat nuk kanë mekanizma rregullues.</p> <p>5. Në lidhje me pjesën e arsytimit të mendimit profesional për kërkesat e</p>
--	--	--

		<p>parashtruara <b>Pika 6</b> mos aplikimi i rabateve gjë e cila është e ndaluar.</p> <p>Normat e udhëzimit administrativ nuk flasin për rabate dhe aksione. Ato kanë përcaktuar çmimet shitëse me shumicë dhe pakicë dhe pjesa e rabateve apo aksioneve rregullohet edhe me norma të tjera financiare të cilat bëhen në mes të prodhuesve, distributorëve apo barnatoreve.</p> <p>6. Në lidhje me pjesën e arsyetimeve të mendimit profesional për kërkesat e parashtruara <b>Pika 7</b> e deklarimi vullnetar nuk është marrë parasysh.</p> <p>Kjo pjese e deklarimit të çmimit nga ana e shitësve me shumicë nuk është relevante pasi që UA ka të përcaktuar se deklarimin e bën <b>mbajtësi i autorizimit të marketingut</b> apo me autorizim distributori apo përfaqësuesi ligjor i tyre. Kurse komisioni në këtë rast ka zbatuar metodologjinë e udhëzimit dhe ka bërë krahasimet e kërkuara apo përcaktuara.</p> <p>7. Në lidhje me pjesën e arsyetimeve të mendimit profesional për kërkesat e parashtruara <b>Pika 12</b> do të trajtojë problemet që do të shfaqen me konkurrencën.</p> <p>Pas, fillimit të periudhës së implementimit të Udhëzimit Administrativ rreth unifikimit të çmimit të produkteve medicinale, pasi që ende autoriteti përkatësisht Ministria e Shëndetësisë nuk e ka përfunduar këtë proces duke qenë në fazën e shqyrtimit të ankesave, Autoriteti i Konkurrencës do të trajtojë problemet nëse ato do të shfaqen në lidhje me konkurrencën në sektorin farmaceutik. Gjatë vlerësimit do të identifikohen nëse ekzistojnë arsyetime për çdo kufizim të konkurrencës dhe do të vlerësojmë nëse alternativat më pak kufizuese do të arrijnë qëllimin e synuar të politikës shëndetësore. Ne gjithashtu do të bëjmë rekomandime dhe sugjerime për qasje alternative për të arritur qëllimet e politikës shëndetësore duke reduktuar kufizimet në konkurrencë, ne bashkëpunim me palët e interesit.</p>
--	--	---

## 5. TREGJET E MONITORUARA

Rasti 1	Sektori i Sigurimeve	<p>Arsyeja kryesore e këtij shqyrtimi paraprak/monitorimi është të përcaktoje strukturën e tregut dhe pjesëmarrësit në tregun përkatës, fuqinë përkatëse si dhe një pamje të situatës, fenomeneve dhe dobësitë e mundshme të tregut që në raste të caktuara mund të shkaktojnë shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.</p> <p>Qëllimi i analizës së kushteve konkurruese është përcaktimi i pikave të forta dhe të dobëta të konkurrentëve brenda këtij tregu, pengesa që mund të zhvillohen për të parandaluar hyrjen e konkurrentëve në treg, dhe çdo dobësi që mund të shfrytëzohet brenda ciklit të zhvillimit të produktit. Përmes analizës të kushteve konkurruese AKK-ja do të analizoj pikat e forta dhe të dobëta të konkurrenteve brenda këtij tregu.</p> <p>Përmes këtij hulumtimi me qëllimin e rishikimit të situatës së përgjithshme në tregun përkatës do mundohemi ti mbulojmë disa segmente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përcaktimi i pjesëmarrësve në treg dhe struktura e tregut,</li> <li>2. Dinamika e ndryshimeve në këtë sektor</li> <li>3. Analiza e shkallës dhe intensitetit të konkurrencës bazuar në aksionet e tregut</li> <li>4. Forca ekonomike dhe financiare e pjesëmarrësve në treg</li> </ol> <p>Në tregun e sigurimeve në Republikën e Kosovës, vërehet qartë që, çmimet MTPL të rregulluara nga shteti nuk janë treguar efikase dhe tregu nuk është eficientë, pra ka nevojë për ndërhyrje. Nga gjetjet dhe analizat, rekomandimet e grupit punues janë që, tregu i sigurimeve, me saktësisht produkti I detyrueshëm nga auto përgjegjësia MTPL, duhet të filloj përgatitjet që të kaloj në tregun e rregulluar pjesërisht, me një sërë tarifash të lejuara (Tavan dhe DysHEME) e pastaj dalëngadalë me çmimet e tregut plotësisht të liberalizuar për MTPL, marr parasysh edhe nga pritja e Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe angazhimin e saj në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.</p>
Rasti 2	Sektori i Energjisë Elektrike	<p>Projekti i Komisionit Evropian i cili është në mbështetje të AKK-së me kërkesë të institucionit, ka bërë analizën e mangesive legislative dhe analizën e tregut në sektorin e energjisë. Nga këto dy dokumente të bëra nga Projekti në bashkëpunim me AKK, kanë filluar</p>

		procedurat hetimore kundrejt dy ndërmarrjeve KEDS dhe KESCO.
Rasti 3	Sektori i Çimentos	<p>AKK ka analizuar tregun e çimentos ne Kosove, duke nxjerre strukturen e tregut, pjesemarrsit ne tregun perkates, sjelljen e tyre, perparesite ose dobesite dhe nivelin e konkurrences ne kete treg.</p> <p>Kemi analizuar prodhimin vendor te cimentos, importin e kompanive kryesore qe afarojn ne kete treg, pjesemarrjen e tyre ne tregun e Kosoves, per periudhen 3 vjeçare (2018, 2019 dhe 2020) gjithashtu kemi bere krahasimin e cmimeve me tregjet rajonale (Shqiperi, Maqedoni e Veriut ne raport me prodhimin vendor).</p>
Rasti 5	Sektori i Shëndetësisë - Labororet e Licensuar per testim SARC-COV19	<p>Pas vendimit të Bordit për Licencim të Institucioneve Private Shëndetësore për lejimin e shërbimeve të testimeve për SARS-Cov 2, dhe duke u mbështetur në listën e laboratorëve të licensuar për të kryer këto shërbime dhe gjithashtu duke u mbështetur në LIGJI Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 28 paragrafi 2 neni 30, neni 38 par. 1 dhe neni 61 par.3 si dhe nenit 4 “<b>Marreveshjet e ndaluara</b>” nën paragrafi 1.1 caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. si ndërmarrje e licensuar për kryerjen e testeve (shërbimeve) molekulare dhe serologjike për SARS Cov-2 jeni të detyruar që t’i zbatoni dispozitat e nenit 4 nen par. 1.1 te LIGJI Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS, duke ju shmangur çfarë do marrëveshjeje të ndaluar apo bashkërendim të aktiviteteve tuaja me ndërmarrjet tjera të cilat kryejnë të njejtin shërbim.</li> <li>2. Çmimet e këtyre shërbimeve duhet të variojnë nga laboratorin në laborator, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenin 10, bazuar në parimin e Mikroekonomisë (Ofertë dhe Kërkesë), bazuar në parimin e produkteve dhe shërbimeve kualitative, bazuar në koston e importit individual, bazuar në shpenzimet operative dhe shpenzimeve tjera të ndërmarrjes suaj.</li> <li>3. Duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e aktiviteteve tuaja të cilat janë ofrimi i shërbimeve për kryerjen e testimit për COVID -19 për qytetarët e Republikës së Kosovës,</li> </ol>

		<p>Autoriteti Kosovar i Konkurrencës këtë shërbim ekonomik e konsideron si aktivitet në shërbim të <b>interesit publik</b> e rrjedhimisht e konsideron si <b>interes shtetërorë</b>.</p> <p><b>ANDAJ:</b></p> <p>4. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të jetë i pa kompromisë nëse vëren ndonjë keqpërdorim, abuzim apo edhe çfarë do kushti tjetër tregtar i vendosur nga ndërmarrja juaj, e i cili në mënyrë të konsiderueshme do ta ç'rregullonte konkurrencën në treg në dëm të qytetarëve të Republikës së Kosovës.</p> <p>5. Se ç'farë u tha më lartë, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës <b>kërkon nga ju,</b></p> <p>a. Të Hënën 17.08.2020 deri në ora 16:00 ta dorëzoni Listën e çmimeve për shërbimin e kryerjes së testeve molekulare dhe serologjike për SARS Cov-2 në mënyrë elektornike.</p> <p>b. Çdo të hënë, deri në përfundimin e pandemisë ta dorëzoni qarkullimin javorë të shërbimeve për testet molekulare dhe serologjike për SARS Cov-2 në excel në mënyrë elektronike.</p> <p>c. Çdo të hënë, deri në përfundimin e pandemisë ta dorëzoni importin e testeve molekulare dhe serologjike për SARS Cov-2 në formë të DUD-it doganor dhe atë ta bëni në mënyrë elektronike.</p> <p>d. Të premtën 21.08.2020 deri në ora 16:00 ta dorëzoni planin e biznesit tuaj.</p>
Rasti 6	Sektori i Radio-taksive	<p>Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 28 paragrafi 2, neni 30, neni 38 paragrafi 1, dhe neni 61 paragrafi 3, me datë 15.10.2020, Komisioni i AKK-se ka autorizuar sekretariatit- Departamentin për mbikëqyrjen e Tregut, TE SIGUROJ INFORMATA për tregun e shërbimeve të taksive, qëllimi i të cilave është analiza e kushteve të konkurrencës për këtë shërbim, kompanive të cilat operojnë në tregun e shërbimeve të taksive në Republikën e Kosovës.</p>




## BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një mjet të rëndësishëm për forcimin e të kuptuarit të lidhjes në mes të subjekteve të ndryshme ndërkombëtare të cilat i lidh interesi dhe synimi i përbashkët, dhe siguron kornizën për zbatimin e parimeve të këtij bashkëpunimi në praktikë.

AKK e vlerëson lartë dhe është i përkushtuar për realizimin sa më të suksesshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar sepse është i vetëdijshëm se bashkëpunimi ndërkombëtar promovon mësimin e ndërsjellë, dialogun dhe shkëmbimin e të dhënave dhe njohurive, që nga ana tjetër e përparon zbatimin dhe funksionalizimin e nexus parimeve.

Për shkak të dominimit të rrethanave të pandemisë, dhe kufizimit të lëvizjeve gjatë vitit 2020, bashkëpunimi ndërkombëtar është zhvilluar kryesisht nëpërmjet te pjesëmarrjes dhe qëndrimeve proaktive te eksperteve te AKK-së në seminarët dhe komunikimet e tjera on-line me subjektet ndërkombëtare, te cilat përkujdesen për zbatimin sa më të përpiktë të standardeve të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Këto takime dhe seminare janë të paraqitura ne pasqyrën e mëposhtme.

		
<p>1. Zyrtaret e AKK-se kanë marrë pjesë ne seminarin e organizuar nga RCC/OECD me temen - <i>Zbatimi I konkurrencës dhe avokimi në sektorin bankar dhe të Sigurimeve</i></p>	<p>2. Gjatë vitit 2020, Autoriteti Kosovar I Konkurrences ka qene aktive në seminarët e organizuar nga RCC në Budapest për tema të ndryshme të Konkurrencës.</p>	<p>3. Instituti i vjenes për Studime të ekonomisë internacionale, ka organizuar trajnim të vecant me temën Konkurrueshmeria, sfidat, ngritjet dhe krizet, ku edhe Autoriteti i Konkurrences ka qenë pjesemarrës në mesin e 17 shteteve të botës. Zyrtaret e AKK-se janë shquar për ekselence dhe janë shpërblyer me mirenjohje.</p>



		
<p>4. Pjesmarrës në Webinar të organizuar nga UNCTAD me temat lidhur me politikat e konkurrencës në theks të veçantë lidhur me situatën me pandemin Covid19.</p> <p>5. AKK-se ka marr pjesë në rrjetin e përbashkët me ICN dhe OECD përmes Webinarit/Zoom me temat investigimi i Autoriteteve të Konkurrencës gjat krizës me pandemin covid19.</p>	<p>6. Gjate vitit 2020, Autoriteti i Konkurrencës ka qen pjesmarrës në forumin e stambollit për konkurrence, në të cilin kanë marr pjes zyrtarët e AKK-së me temat lidhur me pozitën dominuese dhe abuzimi me pozitën dominuese si dhe përqendrimet.</p> <p>7. Treajnimet e organizuar përmes Webinar/Zoom në 6 sesione Brenda vitit 2020, nga projekti i BE-së për mbështetje në ngritjen e kapaciteteve të AKK-së,</p>	<p>8. AKK-se me ndihmën e LUX DEVELOPMENT, ka organizuar një sesion mbi hulumtimin për mbikqyrjen e tregut.</p>

## PËRFAQËSIMET, ANKESAT DHE KËRKESAT NË GJYKATA TË PARAQITURA NË FORMË TABELARE

	VITI 2020
Gjykatën Themelore të Prishtinës	Me datë 17.12.2021. Përfaqësimi A.nr.515/18, ndaj NTSH Doni et al e cila kërkon Anulimi i Aktit-Konkluzionit të datës 27.02.2018. Me nr Prot 92/18-02/D dt 27.02.2018
Përgjigje në padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës	Më datë 21.10.2020. AKK -PËRGJEGJE NË PADI A.nr.515/18, ndaj NTSH Doni et al e cila kërkon Anulimi i Aktit-Konkluzionit të datës 27.02.2018. Me nr Prot 92/18-02/D dt 27.02.2018
Aktgjykime nga Gjykata Supreme e Kosovës	<p>1. Më datë 25.06.2020. Rasti K.S “Sigma” Sh.a.AKTGJYKIM UZVP-ARJ nr.9/2020 me Nr. Prot. 213/20-01/H dt. 25.06.2020 Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të paditurit-Autoriteti Kosovar të Konkurrencës, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë, e parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. UZH.nr. 396/2018, i dt. 05.11.2019.</p> <p>2. Më datë 02.11.2020 Rasti Posta e Kosoves Sh.a.,, AKTGJYKIM, ARJ.UZVP nr.14/2020 me Nr. Prot. 333/20-01/H dt. 02.11.2020</p> <p>Aprovohen si të bazuar kërkesa e paditësit Posta e Kosovës sh.a, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH nr.</p>

	446/2018 të datës 01.10.2019, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë Departamentit për Çështje Administrative, A.U. nr. 2016/2016 date 08.06.2018, dhe çështja i kthehet në rishqyrtim gjykatës së shkallës së parë.
--	---

## SFIDAT DHE REKOMANDIMET E INSTITUCIONIT

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë ushtrimit të detyrave të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, vazhdon të jetë i ballafaquar me sfida si të aspektit teknik, organizativ e funksional, siç janë:

1. Ligji 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës është ndryshuar me plotësim ndryshimin nr. 04/L-226 ndërsa sfida në vete mbetet që Ligji të ndryshohet në tërësi duke e harmonizuar me Direktivat e BE-së,
2. Statuti i Autoritetit duhet të harmonizohet me Ligjin në fuqi,
3. Trajnimi i gjyqtarëve, për një njohje sa më të plotë dhe adekuate të veçorive të ligjit të konkurrencës, si dhe të së drejtës europiane në këtë fushë, me synim arsyetimin e vendimeve të tyre, bazuar në një vlerësim real të konkurrencës, si një e mirë publike.
4. Avokimi me bizneset e mëdha, të mesme dhe të vogla.
5. Avokim me mediat të cilat janë një faktor shumë i rëndësishëm.
6. Ngritjen e kapaciteteve (trajnimi) të stafit në përgjithësi.
7. Monitorimi dhe fillimi i procedurave për shkelësit e Konkurrencës (sipas detyrës zyrtare) ex officio.
8. Sfide e Autoritetit mbetet kontrollat e paparalajmeruar ndaj ndermarrjeve dhe konfiskimi i fakteve.
9. Sfide e Autoritetit gjithashtu mbetet promovimi i programit të lehtësirave nga ndermarrjet.

### Rekomandimet e Autoritetit për vitin 2021

Në përputhje me objektivat strategjike dhe operacionale të përcaktuara për vitin 2021 dhe në përputhje me dispozitat e pikës së dhjetë të parë të paragrafit të parë të nenit 28 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, si dhe të pikës së parë të paragrafit të dytë të nenit 12 të Statutit, Autoriteti rekomandon si prioritete të politikës së konkurrencës për vitin 2020, këto aktivitete:

1. Harmonizimi i metutjeshëm i akteve nenligjore me direktivat evropiane.
2. Krijimi i një baze të të dhënave, përmes të cilës do të bëjmë grumbullimin e të dhënave dhe ruajtjen e tyre.
3. Rritja e stafit,
4. Përgatitja e disa pamfletëve bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës përmes të cilave duhet kushtuar një rëndësi të madhe rritjes së ndërgjegjësimit publik për përfitimet që vijnë nga konkurrenca apo rritjen e kulturës së konkurrencës. Te cilat janë parapare të përgaditen me Planin e Aktiviteteve të Projektit të BE që jemi përfitues si Institucion.

5. Bashkëpunimi me rregullatorët tjerë të tregut, përmes të cilëve synojm të bëjmë transparencën e veprimtarisë së punës së AKK-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare, duke rritur vazhdimisht bashkëpunimin me entet e ndryshme publike, veprimtaria e të cilëve mund të ketë ndikim në konkurrencë.
6. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve që iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive dhe të veçanta, duke dhënë rast pas rasti rekomandimet përkatëse.
7. Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimeve të inspektorëve, me qëllim rritjen e ekspertizës jo vetëm për hetimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike, për të identifikuar sjelljen e ndërmarrjeve në treg.
8. Fokusi i veprimtarisë së Autoritetit ka qenë jo vetëm monitorimi, analizimi, dhe evidentimi i situatave të paqarta dhe të dyshimta por edhe propozimi i masave dhe rekomandimeve konkrete për kapërcimin e tyre. Moto jonë institucionale përgjatë gjithë vitit të kaluar ishte se nxitja dhe mbrojtja e konkurrencës së lirë mbi gjithçka i shërben interesave të konsumatorit të thjeshtë dhe prosperitetit ekonomik dhe social

## RAPORTI FINANCIAR

Raportimi financiar është sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme dhe përbushë të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe nga Ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116, nr.04/L-194, nr.05/L-007 dhe nr.05/L-063.

Të dhënat janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur. Zhvillimet buxhetore të AKK-së në vitin 2020, ishin si në vijim:

Buxheti i lejuar dhe i shpenzuar sipas kategorive:

Nr.	Kategoria	Buxheti i lejuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja e shpenzuar
1.	Paga dhe mëditje	246,782.00	245,556.64	99.50%
2.	Mallra dhe Shërbime	47,981.16	36,981.79	77.07%
3.	Shpenzime Komunale	1,500.00	983.05	65.53%
	<b>TOTALI</b>	<b>296,263.16</b>	<b>283,521.48</b>	<b>95.69%</b>

Raporti Financiar i AKK-se në mënyrë të detajuar është i bashkangjitur me këtë raport

## RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZAP-IT

### RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE TË ZKA-së

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka përgatitur planin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA, në bazë të raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2020.

Te bashkangjitur me kete raport keni edhe adresimin e rekomandimeve te ZAP-it.

Nr	Çështja E gjetura Ndikimi Rekomandimi	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1.	<p><b>Çështja A1: Dobësi në menaxhimin e shpenzimeve të automjeteve</b></p> <p><b>E gjetura:</b> Udhëzimi Administrativ për përdorimin e automjeteve zyrtare, obligon që drejtuesit e automjeteve zyrtare duhet të mbajnë evidenca të udhëtimeve dhe kopjet e faturave të furnizimeve të karburanteve, servisimit etj. Gjatë testimit të katër (4) pagesave për derivate në vlerë 1,438€, ne kemi vërejtur që prej 7 automjeteve, prej tyre 4 sish nuk mbajn evidenc të librit të udhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për të vërtetuar shpenzimet e ndodhura. Kjo ishte bërë si rezultat i kontrollit jo të mirë të këtyre shpenzimeve.</p> <p><b>Ndikimi:</b> Mos mbajta e evidencës së librit të udhëtimeve dhe kilometrave mund të ndikojë në menaxhimin jo të mirë të shpenzimeve.</p> <p><b>Rekomandimi A1:</b> Kryetari i AKK-së duhet të siguroj që për të gjitha</p>	<p>Kryetari i AKK-së siguron që të gjitha automjetet që janë në pronësi dhe shfrytëzim të AKK-së, nga data 01.09.2020 nuk mund të shfrytëzohen pa mbajtjen e evidences së udhëtimeve.</p>	31.08.2020.	Drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit të AKK-së.

automjetet që janë në shfrytëzim apo në pronësi të AKK-së, mbahen evidencat e udhëtimit dhe kilometrave për secilin udhëtim.

# SHTOJCAT

## ORGANOGRAMI I AKK-së




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

### ORGANOGRAMI I AKK-së



Kryetari i AKK-së

Anton Prestreshi